



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10 / 16 gusht 2010), si dhe nenin 14, paragrafi 11, dhe nenin 22, paragrafi 7, nënparagrafi b, të Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore në mbledhjen e mbajtur më datë 29 nëntor 2018, miratoi këtë:

Rregullore për financimin dhe vlerësimin aktuarial të pensioneve me shuma të caktuara

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kërkesat e financimit të Pensionit me Shuma të Caktuara, dhe standardet minimale që do të zbatohen nga Aktuari për përgatitjen dhe kompletimin e raporteve të vlerësimit aktuarial.
2. Kjo rregullore aplikohet për Fondet Plotësuese Pensionale të Punëdhënësit (Fondet Pensionale) dhe Ofruesit e Pensioneve, që ofrojnë Pensione me Shuma të Caktuara të Pensioneve Plotësuese Individuale. Kjo rregullore gjithashtu aplikohet për aktuarët që llogarisin dhe certifikojnë vlerësimet aktuariale në lidhje me Skemën e Pensionit me Shuma të Caktuara.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e përcaktuara në nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës dhe Ligjit nr.04/L-168 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (më tej Ligji për Fondet Pensionale) ose/dhe me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - 1.1. *Aktuari* - nënkupton një person i licencuar nga një organizatë shtetërore ose profesionale e një shteti që është anëtar i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim dhe që bazuar në edukimin, trajnimin dhe përvojën e tij/saj, vlerësohet se posedon shkathtësitë për kryerjen e llogaritjeve matematikore në lidhje me vlerësimin dhe financimin e

programit të Pensionit me Shuma të Caktuara, që punon si i pavarur ose për ndonjë firmë, dhe që pranohet nga BQK-ja si aktuar i kualifikuar për pensione.

- 1.2. *Raporti aktuarial* - nënkupton raportin e nënshkruar nga aktuari, që pasqyron mjetet dhe detyrimet e Pensionit me Shuma të Caktuara si dhe kërkesat e financimit, metodat, supozimet dhe të dhënat e përdorura në arritjen e përfundimeve aktuariale.
- 1.3. *Detyrimet Aktuariale* - nënkupton, nga data përkatëse e vlerësimit të Pensionit me Shuma të Caktuara, më të lartën e elementeve në vijim:
 - 1.3.1 Aftësia paguese ndaj detyrimeve (“solvency liability”) ose
 - 1.3.2 Vlera aktuale e benefitit të pensionit e shpërndarë për periudhën menjëherë para datës së vlerësimit në pajtim me metodat aktuariale të përdorura për përcaktimin e kontributit normal.
- 1.4. *Pasqyrat financiare vjetore të audituara* - nënkupton pasqyrat financiare të përgatitura në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe të audituara nga auditori i jashtëm i licencuar në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- 1.5. *Deficiti* - nënkupton shumën me të cilën detyrimi aktuarial i tejkalon mjetet e pensionit në datën e vlerësimit.
- 1.6. *Fondi* - nënkupton shumën e mjeteve që janë ndarë për të mbështetur programin e Pensionit me Shuma të Caktuara.
- 1.7. *Treguesi i financimit* - nënkupton raportin e mjeteve ndaj detyrimeve aktuariale.
- 1.8. *Plotësisht i financiar* - nënkupton gjendjen financiare të Pensionit me Shuma të Caktuara ku mjetet e pensionit janë të barabarta ose më të mëdha se detyrimi aktuarial.
- 1.9. *Plani i financimit* - nënkupton metodologjinë e financimit të të drejtave të fituara. Metodologjia e financimit e lejuar për Pensionin me Shuma të Caktuara është një “prim i vetëm”(“single premium”) e aplikueshme për periudhën ose periudhat e caktuara të viteve të fituara (akumuluar) të shërbimit.
- 1.10. *Kontributi normal* - nënkupton shumën e kontributit që është i nevojshëm që të financojë vlerën aktuale të benefiteve të pensionit që janë shpërndarë për një vit të caktuar, në pajtim me metodën e vlerësimit aktuarial të përdorur.
- 1.11. *Para-plani i deficitit* - nënkupton pjesën e deficitit të krijuar në programin e Pensionit me Shuma të Caktuara që iu takon viteve të kredituara të shërbimit të përlloritur, të destinuar për vitet e shërbimit para datës efektive të akteve normative të Fondit Pensional dhe i përfshirë si shërbim i arritur në raportin e parë të vlerësimit aktuarial të përgatitur në pajtim me këtë rregullore.
- 1.12. *Deficiti i shërbimit të mëparshëm* - nënkupton deficitin e krijuar në Fondin Pensional që iu takon viteve të kredituara të shërbimit, të destinuar për periudhat e shërbimit më ose pas datës efektive të akteve normative të Fondit Pensional. Me fjalë të tjera, ky term

nënkupton deficitin që nuk përfshin mbetjen (pjesën e pa likuiduar) të para-planit të deficitit.

1.13. *Sponsor* - nënkupton punëdhënësin në Fondin Plotësues Pensional të Punëdhënësit, ose Ofruesin e Pensionit në Pensionin Plotësues Individual, që ofron Pension me Shuma të Caktuara.

1.14. *Aftësia Pagueuse ndaj detyrimeve* (“*Solvency Liability*”) - nënkupton, prej datës përkatëse të vlerësimit të Pensionit me Shuma të Caktuara, më të lartën e:

1.14.1 kontributeve të akumuluar të pjesëmarrësit plus interesi; ose

1.14.2 vlerën aktuale të benefiteve të pensionit, e llogaritur sikur Fondi shuhet në datën e vlerësimit aktuarial, me supozimin që secili pjesëmarrës është me të drejta të plota të fituara në Fond.

1.15. *Teprica* - nënkupton tejkalimin e mjeteve të pensionit mbi detyrimet aktuariale.

Neni 3

Financimi i Pensionit me Shuma të Caktuara

1. Sponsori është përgjegjës për mbajtjen e Pensionit me Shuma të Caktuara në kushte plotësisht të financuara ose nëse ky kusht nuk është plotësuar, gradualisht të sjell Pensionin me Shuma të Caktuara në kushte plotësisht të financuara. Sponsori duhet të sigurojë se kontributet që i referohen paragrafit 2 të këtij neni janë depozituar në Fond, në shumat dhe brenda kohës siç definohet në aktet normative të Fondit Pensional, apo rregullave të pensionit, dhe në pajtim me Deklaratën e Aktuarit të përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje.
2. Sponsori duhet të bëjë pagesa Fondit, për:
 - 2.1 Kontributet normale për dhe në emër të pjesëmarrëseve sikur që është përcaktuar në aktet normative të Fondit Pensional ose rregullat e pensionit në pajtim me kërkesat e vlerësimit aktuarial të aplikuar.
 - 2.2 Kontributi plotësues i nevojshëm që të financojë dhe mbulojë deficitin në Fond në lidhje me deficitin e para-planit ose deficitin e shërbimit të mëparshëm.
3. Fondi Pensional dhe Ofruesi i Pensioneve që implementon programin e Pensionit me Shuma të Caktuara duhet të raportojë në BQK kualitetin e financimit të pensioneve të tyre, së bashku me raportet e tyre vjetore edhe raportet e vlerësimit aktuarial. Të njëjtat duhet t’i dërgohen BQK-së sa herë që kërkohen prej saj. Kualiteti i financimit përfshin cilëndo prej klasave në vijim:
 - 3.1 Klasa A, mjetet e pensionit janë të barabarta ose më shumë se detyrimet aktuariale (plotësisht i financiar).

- 3.2 Klasa B, mjetet e pensionit janë më pak se detyrimet aktuariale mirëpo janë të barabarta ose më shumë se aftësia paguese ndaj detyrimeve (“solvency liability”).
- 3.3 Klasa C, mjetet e pensionit janë më pak se detyrimi i aftësisë paguese “Solvency liability”
4. Në përcaktimin e kualitetit të financimit, Fondi Pensional dhe Ofruesi i Pensioneve duhet të krahasojnë mjetet e pensionit kundrejt provizioneve të themeluara si detyrime aktuariale dhe aftësisë paguese ndaj detyrimeve “solvency liability”. Vlera e mjeteve të pensionit që duhet të shfrytëzohet në këtë krahasim duhet të jetë vlera totale e mjeteve të pensionit sikur që është pasqyruar në gjendjen e fundit financiare vjetore të audituar dhe/ose raporti i portofoliove të investimit që ka datë të njëjtë të vlerësimit me detyrimet.
 5. Deficiti i para-planit i krijuar në raportin e parë të vlerësimit aktuarial të programit të Pensionit me Shuma të Caktuara duhet të financohet me kontribute shtesë mujore të barabarta, brenda periudhës jo më shumë se 60 muaj prej datës efektive të akteve normative të Fondit Pensional apo rregullave të pensionit.
 6. Deficiti i shërbimit të mëparshëm në programin e Pensionit me Shuma të Caktuara duhet të financohet me kontribute shtesë mujore të barabarta, brenda periudhës prej 12 muajsh prej kohës që është paraqitur në raportin e vlerësimit aktuarial.
 7. Shuma e kontributeve shtesë mujore për të financuar deficitin, duhet të përcaktohet në atë mënyrë që vlera aktuale e pagesave të kontributeve shtesë mujore të kërkuara gjatë periudhës financuese është e barabartë me deficitin për të cilin bëhet fjalë.
 8. Në raportin e vlerësimit aktuarial, shuma e kontributeve plotësuese mujore për të financuar deficitin mund të rillogaritet dhe rregullohet ashtu që të përputhen me kërkesat e paragrafit 7 të këtij neni.
 9. Nëse vlerësimi pasues aktuarial tregon tepricë, kontributet shtesë mujore të mbetura mund të ndalen. Nëse teprica është më e lartë se 20% e detyrimeve aktuariale, kjo tepricë mund të shfrytëzohet si kontribut normal i punëdhënësit dhe pjesëmarrësit në proporcion me raportin e ndarjes së tyre për kontributet normale.

Neni 4

Standardet e Vlerësimit Aktuarial

1. Çdo ofrues i Pensionit me Shuma të Caktuara duhet të përgatis raportin e vlerësimit aktuarial sikurse kërkohet me këtë rregullore dhe ta dorëzojë në BQK.
2. Vlerësimi aktuarial duhet të bëhet nga data efektive e zbatimit të akteve normative të Fondit Pensional ose rregullave të pensionit, sipas afateve dhe kritereve si vijon:
 - 2.1 Në baza vjetore, në fund të vitit financiar të Fondit të Pensional i cili ka më shumë se 1000 pjesëmarrës.

2.2 Çdo pesë vite, në fund të çdo viti të pestë financiar të Fondit të Pensional i cili ka 1000 ose më pak pjesëmarrës.

2.3 Në baza vjetore, në fund të vitit financiar të Ofruesve të Pensioneve, që ofrojnë programin e Pensionit me Shuma të Caktuara.

Neni 5

Përmbajtja e Raportit të Vlerësimit Aktuarial

1. Raporti i vlerësimit aktuarial duhet të përmbajë të dhënat si vijon:

1.1 Deklaratën e aktuarit;

1.2 Supozimet dhe informacionet mbi të cilat është përgatitur raporti i vlerësimit aktuarial;

2. Deklarata e aktuarit duhet të përmbajë të dhënat si vijon:

2.1 Deklaratën e aktuarit se sipas njohurive të tij, të dhënat e marra dhe të shfrytëzuara nga ai janë të plota dhe janë llogaritur për qëllime të përgatitjes dhe kompletimit të raportit dhe se ato të dhëna kanë qenë subjekt i testimeve të arsyeshmërisë dhe pajtueshmërisë në raport me Pensionin me Shuma të Caktuara.

2.2 Një deklaratë që raporti:

2.2.1 Është në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit për Fondet Pensionale dhe këtë rregullore;

2.2.2 Është përgatitur mbi bazën e përcaktimeve të akteve normative të Fondit Pensional dhe të rregullave të pensionit, të aplikueshme;

2.2.3 Supozimet e përdorura janë në pajtueshmëri me parimet e pranueshme të vlerësimit të pensionit dhe standardeve që aplikohen në Pensionin me Shuma të Caktuara;

2.2.4 Metodot e aplikuara gjatë llogaritjes janë në përputhje me parimet e përgjithshme aktuariale të adaptuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Aktuareve (International Association of Actuaries), dhe të pranuar nga Standardet Ndërkombëtarë të Kontabilitetit (International Accounting Standards).

2.3 Konfirmimi dhe konkluzionet për shumën e mjeteve të pensionit, detyrimet aktuariale, aftësinë paguese ndaj detyrimeve (“solvency liability”), teprica ose deficiti dhe kualiteti i financimit, nga e njëjta datë e vlerësimit.

2.4 Llogaritjen dhe konkluzionet lidhur me:

2.4.1 Mjaftueshmërinë e shumës së kontributit normal i cili duhet të paguhet për vitet financiare që pasojnë, i ndarë në kontribute që janë paguar nga pjesëmarrësi dhe kontributet që janë paguar nga sponsori.

2.4.2 Mjaftueshmërinë e formulës në llogaritjen e shumës së kontributit normal që do të paguhet për periudhat ose vitet deri në vlerësimin e ardhshëm aktuarial.

2.5 Llogaritjen dhe konfirmimin e mjaftueshmërisë së shumës së kontributeve plotësuese mujore që është e nevojshme për ta financuar deficitin, nëse ekziston.

3. Raporti i vlerësimit aktuarial duhet të përmbajë nënshkrimet e aktuarit dhe zyrtarëve të autorizuar të sponsorit ose zyrtarëve të autorizuar të Fondit Pensional ose të Ofruesit të Pensioneve si dhe duhet të shoqërohet me dokumentet si në vijim:

3.1 Deklaratën nga zyrtari i autorizuar i Fondit Pensional ose Ofruesit të Pensionit, që vërteton se të dhënat dhe aktet normative të pensionit ose rregullat e pensionit të ofruara për aktuarin janë komplete dhe të sakta.

3.2 Vendimin nga organet më të larta drejtuese të sponsorit, që konfirmon se sponsori kupton kualitetin e financimit të Pensionit me Shuma të Caktuara. Në rastin e Fondit Pensional, deklarata që ripohon aftësinë e punëdhënësit për t'i kryer pagesat e kontributeve në pajtim me shumën dhe kohën e përcaktuar në deklaratën e aktuarit.

Neni 6

Përgjegjësitë Fiduciare të Aktuarit

1. Llogaritjet, konfirmimet dhe konkluzionet e aktuarit në raportin e vlerësimit aktuarial janë detyra fiduciare të Fondit Pensional dhe Ofruesit e Pensioneve, që ofrojnë Pensione me Shuma të Caktuara të Pensioneve Plotësuese Individuale.
2. Nëse Fondi Pensional, Ofruesit e Pensioneve ose BQK-ja vërteton se raporti i vlerësimit aktuarial ose deklarata e aktuarit nuk është në pajtim me kërkesat e Ligjit për Fondet Pensionale, këtë rregullore dhe/ose aktet normative të Fondit Pensional ose rregullat e pensionit, apo nëse vlerësimi aktuarial nuk është kryer në pajtim me parimet e përgjithshme aktuariale të pranura, Fondi Pensional apo Ofruesit e Pensionit nuk do të emërojnë aktuarin e njëjtë për të kryer raportin e vlerësimit aktuarial ose për të përgatitur deklaratën aktuariale për 5 vitet e ardhshme.
3. Në rastet sikurse është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, Fondi Pensional dhe apo Ofruesi i Pensioneve, mund ta padisë aktuarin për t'i kompensuar dëmet që i ka shkaktuar aktuari për shkak të vlerësimit aktuarial të gabuar. Ushtrimi i padisë sipas këtij paragrafi nuk ndikon dhe nuk pengon shqiptimin e masave tjera administrative të parapara me Ligjin për Fondet Pensionale, rregulloret në zbatim të tij, ose legjislacionit tjetër në fuqi.

Neni 7

Zbatimi dhe masat përmirësuese

Shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jenë subjekt i masave të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje do të shfuqizohet Rregulla 15 mbi Financimin dhe Vlerësimin Aktuarial të Rregullimit Pensional me Benefit të Definuar, e datës 23 tetor 2002.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore.

Flamur Mrasori

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore